



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 19

Prishtinë, më 20. 07. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Danush Ademi, Ibrahim Makolli, Hajredin Hyseni, Drita Maliqi, Luljeta Shehu dhe Shpresa Murati.

Munguan: Nerxhivane Dauti dhe Ibrahim Selmanaj.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Ramadani – KDI dhe Elita Vokshi – OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 9.7.2010 dhe 13.7.2010,
3. Shqyrtimi i listës së regjistrimit të aktvendimeve të pa ekzekutuara të KPMK - së.
4. Shqyrtimi i disa peticioneve.
5. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale.
6. Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritëtregtare,
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditë.

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i dy procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtur më 9. 07. 2010 dhe 20. 6. 2010

Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 9.07.2010 pa vërejtje, ndërsa për procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13. 07. 2010, nga kryetari Fatmir Rexhepi pati vërejtje dhe ato u korrigjuan.

3. Shqyrtimi i listës së regjistrit të aktvendimeve të pa ekzekutuara të KPMK - së.

Fatmir Rexhepi – U përkujtojë se në mbledhjen e kaluar Komisioni nxori si konstatim që të mos procedohen një nga një emrat e atyre që janë ankuar, por lista aktvendimeve që nuk janë zbatuar. Prandaj kemi një listë me të gjitha të dhënat dhe i propozoi Komisionit që këtë regjistër ta miratojë në parim. Në vazhdim tha se Komisioni i kërkon kryetarit të Kuvendit të ushtrojë funksionin e vet në kërkim të zbatimit të këtyre vendimeve dhe lidhur me këtë pikë hapi debat.

Hajredin Hyseni - U pajtua me parafolësin dhe propozoi që këtë listë Komisioni t’ia procedojë Kryesisë së Kuvendit dhe ta njoftojë Qeverinë e Kosovës se këto institucione nuk i kanë respektuar vendimet e KPMK - së, prandaj tha se kërkesa është që Qeveria të bëjë tryzni për zbatimin e ligjit lidhur me këto vendime të KPMK - së.

Drita Maliqi - I mbështeti parafolësit dhe i kërkoi Komisionit, që përveç institucioneve të nivelit qendror të kërkohet edhe nga nivelet lokale, nga se shumica e shkeljeve, pra edhe largimeve nga puna është bërë nga organet e niveleve lokale.

Prandaj pas një debati të gjerë dhe konstruktiv, që u zhvillua lidhur me ankesat e qytetarëve të Kosovës, që kanë të bëjnë me moszbatimin vendimeve të KPMK - së njëzëri Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Komisioni e njofton Kuvendin e Kosovës me Regjistrin e vendimeve të plotfuqishme të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që t’ia procedojë Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës, me qëllim që të merren masa për ekzekutimin e tyre.

Procedimi i regjistrit të vendimeve të plotfuqishme të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës bëhet në bazë të nenit 13. 3 të Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK - ut nr. 2001/36 për shërbimin civil të Kosovës.

5. Shqyrtimi i disa peticioneve.

Hajredin Hyseni - Propozoi peticionet të mos shqyrtohen nga se nuk ishte e pranishme Nerxhivane Dauti, të cilën e ka autorizuar Komisioni si raportuese. Komisioni u pajtua që të mos shqyrtohet dhe vendosi në mbledhjen radhës t'i shqyrtojë.

5. *Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për produktet dhe pajisjet medicinale.*

Ibrahim Makolli - Tha se nga aspekti i të drejtave të njeriut amendamentet në këtë Projektligj nuk janë në kundërshtim, përveç amendamentit 24, që është në kundërshtim me ligjin për shërbyesit civilë.

Komisioni konstaton se Projektligji për pajisjet medicinale i Republikës së Kosovës, të Komisionit Funksional, nga aspekti i të drejtave të njeriut, nuk i cenon parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut:

6. *Shqyrtimi i Propozimamendamenteve të Komisionit Funksional në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare*

Komisioni konstaton se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare të Republikës së Kosovës, të Komisionit Funksional, nga aspekti i të drejtave të njeriut, nuk i cenon parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut:

7. Te ndryshme

Drita Maliq - Vërejti se regjistrin të KPMK - së i mungojnë disa emra, që janë nga Komuna e Gjilanit dhe kërkoi që të përfshihen në listën kryesore.

Ibrahim Makolli - Kërkoi listës t'i shtohen të gjithë emrat, pavarësisht se Komisioni a i ka pasur ose jo në shqyrtim, dhe të jetë komplet lista me emrat e ankuesve.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 50.

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi